



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.04.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit 3-javor i punimeve të komisionit, 10 – 30 prill 2015.
2. Projektligji “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”.
3. Shqyrtimi i raportit vjetor për veprimtarinë e KQZ-së për vitin 2014.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia, Spartak Braho.

Mungojë: Tom Doshi, Dashamir Peza, Silva Caka .

Të ftuar:

Milena Harito - ministre Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike

Irena Malolli - drejtore e Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Lefterije Luzi – kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Denar Biba - zëvendëskryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Petrit Gjokutaj - drejtor në Drejtorinë e Informacionit dhe Teknologjisë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi miratimin e kalendarit 3-javor të komisionit.

A ka ndonjë nga kolegët sugjerim për kalendarin? Është reflektim i kalendarit të miratuar nga seanca plenare të enjten e kaluar.

Fjalën e ka zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë doja të informoja komisionin që ne kemi shqyrtuar raportin e veçantë të Avokatit të Popullit lidhur me të drejtat e personave me orientim seksual të ndryshëm LGBT, dhe kemi përgatitur një projektrezolutë, por do të sugjeroja që të shqyrtohet në komision dhe do të ishte mirë që të miratohej para datës 17 maj, për të treguar edhe angazhimin e Kuvendit, sikurse është lënë në raport-progresin e fundit, që ne mbrojmë të drejtat e të gjithë personave dhe respektojmë Kushtetutën. E thashë para 17 maj, meqenëse kjo datë është dita ndërkombëtare e të drejtave të personave, LGBT. Nëse ju e planifikoni, do të ishte mirë, pasi ne tashmë e kemi përfunduar seancën dëgjimore, si dhe shqyrtimin e raportit dhe stafi i Kuvendit ka përgatitur një projekt të rezolutës. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Natyrisht, nënkomisionet kanë axhendën e tyre dhe çdo gjë që kalon në nënkomision duhet të kalojë në Komisionin e Ligjeve. Nënkomisionet kanë pavarësinë e tyre dhe, fakti që ju e keni shqyrtuar dhe vlerësuar, mendoj se është më se i mjaftueshëm, sepse duhet të ketë disa përparësi. Ne e kuptojmë kartën e shoqërisë civile, e cila kishte një përparësi dhe ajo kaloi në formë rezolute në seancën plenare, pra jo çdo dokument që shqyrtojnë nënkomisionet do të kalojë në komision, dhe jo çdo dokument që shqyrtojnë komisionet duhet të kalojë patjetër në seancë plenare. Gjithsesi mbetemi të hapur.

Fjalën e ka zoti Fino!

Bashkim Fino – Shoh se më keni vendosur relator te raporti i Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, ndërkohë që ka anëtarë të tjerë të komisionit më të aftë për të qenë relatorë për këtë çështje, por, në qoftë se nuk ka, nuk ka problem që të jem edhe unë, por ngaqë jam në gjëra të tjera e thashë këtë.

Fatmir Xhafaj – Ne kemi bërë një shpërndarje, gjithsesi...

Bashkim Fino – Nuk kam vërejtje pse jam, por them se, në qoftë se ka ndonjëri dëshirë dhe e njeh më mirë këtë situatë, mund ta bëjë më mirë, ndërkohë që unë mund të bëja diçka tjetër.

Fatmir Xhafaj – Në vlerësim të kësaj që tha zoti Fino, a ka ndonjë nga kolegët që dëshiron të jetë relator te Shërbimi Civil? Zoti Klosi është te KQZ-ja sot.

Kam bërë një shpërndarje tek të gjitha.

Ju lutem, zoti Muçmataj kishit ndonjë gjë? Ju, zoti Majko?

Zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Unë, zoti kryetar, kam diçka lidhur me dy nismat e koleges Bregu, që ju i keni parashikuar në kalendar në datat 27 dhe 28 prill. Për transparencë edhe për komisionin do të doja t'ju informoja që në një takim të zhvilluar me specialistë të medias, organizuar dje nga Ambasada e Holandës dhe e Mbretërisë së Bashkuar, në të cilën mora pjesë edhe unë, janë diskutuar gjerësisht të dyja nismat e koleges, por vura re që kishte qëndrime të ndryshme, sikurse ndamë edhe ne qëndrimet tona, por njëkohësisht në cilësinë e relatores unë kam parashtruar një sërë pikëpyetjesh dhe çështjet që duhen diskutuar me aprovimin tuaj, dhe, njëkohësisht duke ju falënderuar që këtë shqetësim ua keni adresuar të gjitha institucioneve, shoqërisë civile, por edhe ekspertëve të fushës së ligjit. Ne kemi marrë një numër të madh opinionesh, njëkohësisht presim të vijnë opinione nga institucione të tjera si OSBE-ja, Avokati i Popullit, Këshilli i Europës. Gjithashtu, përfitoj nga rasti, meqenëse është edhe zonja ministre, kërkojmë opinionin e institucioneve që ministrja Harito ka në varësi, por unë mendoj që kemi nevojë të bëjmë dy tryeza konsultimi.

Një tryezë duhet të jetë me të gjithë ekspertët e fushës, juristë, konstitucionalistë, mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe me media. Nga diskutimi që doli dje, kërkoj pak më shumë kohë që t'i japim mundësi për t'i shpërndarë edhe pjesës tjetër që nuk kanë marrë draftet e dy projektligjeve për ta studiuar, për t'u dhënë kohë për të zhvilluar edhe këto dy dëgjesa dhe më pas kalojmë në Komisionin e Ligjeve. Bëhet fjalë për ndërhyrjen në dy ligje që janë Kode dhe, që kërkojnë një vëmendje të duhur. Pse kërkojmë dy tryeza? Tryeza e parë ka të bëjë me medien, dhe tryeza e dytë

ka të bëjë me pensionin ushqimor, pra janë dy grupe të ndryshe interesi. Prandaj, nëse do të mundeshim për ta shtyrë, do ta vlerësoja shumë për t'i dhënë kohën e duhur të gjithë këtij diskutimi.

Fatmir Xhafaj – Më fal, që të jemi korrektë për një gjë: të dyja këto janë ligje me 3/5 dhe janë parashikuar për datën 30.04.2014, kurse ne i kemi parashikuar për datat 27 dhe 28 prill. Natyrisht, nëse ne do të mundemi ta mbyllim këtë javën që vjen, do të jetë pozitive që të arrijmë ditën e hënë dhe të martë që t'i shqyrtojmë, nëse nuk do të arrijmë, ne këtu jemi prapë dhe do të vendosim, por ne nuk mund të rrimë pa e programuar një gjë që na detyron seanca plenare.

Seanca plenare ka marrë një vendim dhe ka thënë që në datën 30 do të shqyrtojë këto projektligje dhe ne nuk mund të themi këtu, shiko, ne nuk do t'i shqyrtojmë. Jo, ne do të ecim dhe, në qoftë se nuk arrijmë, pasi edhe Rregullorja e ka njohur që këto do të shtyhen për një seancë patjetër, por ne do të bëjmë maksimumin e mundshëm.

Biem dakord me vërejtjet dhe sugjerimet që u bënë për kalendarin e punës së komisionit? Kush është dakord?

Miratohet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës që është projektligji “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”. E pranishme për të paraqitur projektin dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve është zonja Milena Harito, ministre e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike së bashku me zonjën Malolli, drejtore e Komunikimeve Elektronike dhe Postare të angazhuar për këtë ligj.

Zonja Ministre, faleminderit që jeni prezent! Do të dëshironim një paraqitje të shkurtuar të projektligjit me risitë kryesore për shkak se relacioni është i njohur për kolegët, dhe për të vazhduar më pas me pyetje të mundshme. Meqenëse ky është një projektligj i ri dhe i rëndësishëm, do të qëndrojmë vetëm në diskutimin në parim për t'u krijuar mundësi kolegëve për t'u njohur dhe më pas do të vazhdojmë me diskutimin nen për nen.

Zonja Ministre, fjala për ju!

Milena Harito – Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëdita të gjithëve!

Ligji “Për shërbimin postar” është i vitit 1999, kur në Shqipëri operonte vetëm një operator për shërbimin postar. Do të doja ta shpjegoja që në fillim që ky ligj merret me shërbimin postar si të tillë, pra posta shqiptare, përveç shërbimit postar, kryen edhe funksione të tjera, siç janë

shërbimet financiare, pagesa për të tretët etj., të cilat nuk rregullohen nga ky ligj, por rregullohen nga ligjet e sektorëve të veçantë, për shembull, shërbimet financiare sipas licencave që jep Banka e Shqipërisë. Pra, këtu flasim vetëm për ligjin që rregullon shërbimet postare dhe, siç e thashë, ligji aktual është i vitit 1999 kur kishim vetëm një operator në treg, ndërsa sot kemi 11 operatorë në treg, e para.

E dyta, që nga viti 2012 progres-raporti, në përputhje me direktivat europiane, kërkon liberalizimin e tregut postar. Për këtë arsye janë bërë disa hapa, si reduktimi i asaj që quhet zona e rezervuar dhe sot këtu jemi me këtë ligj të ri, pra pas 16 vjetësh të ligjit ekzistues për të rregulluar një sektor, i cili ka ndryshuar në mënyrë galopante, edhe për arsye të futjes masive të shërbimeve elektronike, të cilat sigurisht që kanë kufizuar qarkullimet që bëheshin më parë vetëm me letra.

Pra, ky ligj është në përputhje me praktikën e Bashkimit Europian, përcakton institucionet përgjegjëse për rregullimin e sektorit postar, të drejtat, detyrimet e ofruesve, operatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve postare. Ka si qëllim sigurimin e ofrimit të shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Shqipërisë, mbrojtjen e interesave të përdoruesve dhe sigurimin e trajtimit të barabartë të tyre, si dhe nxitjen e konkurrencës së lirë midis operatorëve me një qëllim të vetëm përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Këto janë disa nga elementet kryesore.

Ligji aktual parashikon ofrimin e shërbimit bazë postar me të drejta ekskluzive dhe këtë të drejtë ia njeh vetëm postës, dhe kemi përcaktimin e zonës së rezervuar.

Ky ligj bën një transfuzim të direktivës aktuale europiane për çështjet postare dhe është pjesë e planit kombëtar të integritetit, është një hap më tej në rrugën e integritetit, duke përafruar legjislacionin tonë. Nuk sjell ndryshime në kuadrin institucional ekzistues as për detyrat politikëbërëse dhe as për ato rregullatore, pra është një përmbushje e detyrave të lëna në progres-raport. Këto janë elementet kryesore. Nëse keni pyetje, jam në dispozicionin tuaj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Relatorë të këtij projektligji janë zoti Manja dhe zonja Caka.

Zoti Manja, një vlerësim në parim.

Ulsi Manja – Unë do të flas shkurtimisht, pasi çështjet lidhur me përmbajtjen dhe qëllimet e projektligjit u sqaruan nga zonja ministre.

Komisioni ynë në diskutimin e këtij projektligji është caktuar komision për dhënie mendimi, dhe në aspektin ligjor projektligji që propozohet nga Këshilli i Ministrave është në

përputhje me Kushtetutën dhe legjislationin në fuqi, ndërsa në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në cilësinë e relatorit, i propozoj komisionit miratimin në parim të këtij projektligji, duke rezervuar të drejtën për të ndërhyrë gjatë shqyrtimit nën për nën në disa nene të caktuara, kryesisht për sa u takon çështjeve të aspektit të teknikës legjislative.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja, edhe për mbështetjen që i jepni projektit!

Kush ka pyetje?

Zonja Ministre, kam unë një pyetje. Ne sot në sistemin e drejtësisë kemi një problem shumë të madh, problemin e njoftimit të palëve në proces. Ndoshta është një nga pikat kyçe që efektikon drejtpërsëdrejti në aksesin në dhënien e drejtësisë, në shpejtësinë e gjykimit dhe të hetimit, ashtu sikundër mendoj që ky është një problem jo i vogël edhe për qytetarët për shkak të çështjes së adresave, nevojave që kanë, letërkëmbimeve, komunikimeve, ashtu sikundër një pjesë e mirë e ligjeve e lidhin sanksionin ose njoftimin për sanksion me njoftimin e personit, gjë e cila në një pjesë dërrmuese realizohet nga shërbimi postar dhe më pas krijon efekte në marrëdhëniet ankimore, juridiko-civile të tyre me kompanitë përkatëse, por ajo, me sa duket, është çështja e adresave, dhe si mundet të ofrojë shërbimi postar një gjë më me cilësi. Pyetja ime është, ky ligj i jep një shtytje dhe në tërësi ky problem, meqenëse ju keni ardhur ta mbronni këtë, pavarësisht se lidhja nuk është shumë e drejtpërdrejtë, pasi po flasim për sukseset në postën shqiptare, ka vite që kjo histori suksesesh, gati mbi 10 vjet që e dëgjoj këtë histori, ndërkohë që te ne sot një shërbimi normal si në çdo vend të Europës që njohim ne, është që njoftohen në kohë palët ndërgjygjëse, është një nga gjërat më elementare, dhe ne këtë nuk e zgjidhim dot sot në hetim dhe në gjykim dhe krijon jashtëzakonisht pasoja për shpejtësinë dhe për aksesin në drejtësi. Keni ju një koment për këtë ju lutem?

Milena Harito – Po, kam disa elemente për ju. Në të vërtetë ky ligj nuk merret me këtë çështje, pra ky ligj nuk e rregullon këtë çështje, por rregullon mënyrën sesi posta e rregullon shërbimin. Posta nuk ka detyrimin që të administrojë adresat e njerëzve, pra ajo dërgon shërbimin, por sigurisht kjo është një çështje shumë serioze. Për sistemin gjyqësor jam krejtësisht koshiente edhe për shumë shërbime të tjera që u ofrohen qytetarëve. Këtu ka disa elemente, dhe elementi i parë është rregullimi i sistemit të adresarit, për të cilin po ndërmerren disa hapa. Hapi i parë që është ndërmarrë dhe është duke kryer, është realizimi i një fotoje të re ajrore për të identifikuar të

gjitha godinat e Shqipërisë dhe kjo foto e re, pasi ekzistuesja daton prej vitit 2007, kur Shqipëria ka pasur një zhvillim shumë të vrullshëm, pra nuk është më aktuale, mbaron këtë verë dhe më pas ajo do të hidhet, që të identifikohen të gjitha godinat dhe pas identifikimit kjo do të transpozohet në një sistem adresash elektronike. Nga sistemi elektronik për të kaluar në sistemin real do të ketë hapa, që do të duhet të na i realizojnë kryetarët e rinj të bashkive, sepse më pas është puna në terren. Kjo është për sa i përket sistemit të adresave.

Në atë që ju thoni, mendoj se ka edhe diçka tjetër, por besoj se duhet adresuar me Ministrinë e Brendshme, e cila është përgjegjëse për regjistrin e shtetasve dhe mendoj se do të duhet që të gjithë ne këtu të mendojmë një formë detyrimi për shtetasit, për të pasur një adresë detyruese le të themi, pra një adresë ku duhen praktikantët më të mira sesi kjo adresë detyruese për ta në çfarë forme bëhet me një ekzistencë reale, sepse mund të kemi një adresë detyruese në letër, por, nëse ajo nuk merr një ekzistencë reale, kjo gjë nuk i jep zgjidhje problemit që ju ngritët. Mendoj që këtu patjetër do të duhet një punë, por, për fat të keq, nuk është objekt i këtij ligji.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Me sa kuptoj unë, do të kemi një ligj të mirë, por ende një shërbim akoma më të mirë, për sa kohë që e kemi këtë problem. Këtë e ngrita, sepse ne do të kemi në raport prokurorin e Përgjithshëm, do të kemi çështje dhe aspekte që lidhen me reformën në drejtësi dhe kjo është një nga çështjet kryesore. A ka pyetje të tjera? Nuk ka. A ka diskutime në parim? Nuk ka diskutime.

Kush është dakord në parim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet projektligji në parim për t'i hapur rrugë diskutimit nën për nen, ku, siç tha edhe relatori, ka ndërhyrje konkrete.

Faleminderit, zonja Ministre!

Është hera e parë që e kalove me kaq shpejtësi derën e komisionit.

(Mungesë incizimi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.04.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i raportit vjetor për veprimtarinë e KQZ-së për vitin 2014.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia, Spartak Braho.

Mungojë: Tom Doshi, Dashamir Peza, Silva Caka .

Të ftuar:

Lefterije Luzi – kryetare e KQZ-së.

Denar Biba – zëvendëskryetar i KQZ-së.

Dëshira Pasko – drejtore në Drejtorinë Juridike pranë KQZ-së.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

Në këtë pikë kemi shqyrtimin e raportit vjetor për veprimtarinë e KQZ-së për vitin 2014. Nga KQZ-ja janë të pranishëm: zonja Lefterie Luzi, kryetare e KQZ-së, zoti Denar Biba, zëvendëskryetari i KQZ-së.

Vazhdojmë me paraqitjen e raportit nga kryetarja e KQZ-së. Meqenëse raporti është shpërndarë, ka kohë që është në rendin e ditës për shqyrtim të këtij komisioni, do të dëshironim një përmbledhje të shkurtuar.

Zonja kryetare, urdhëroni!

Lefterie Luzi – Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

Të nderuar deputetë,

Ashtu sikurse edhe kryetari i komisionit citoi më parë ne këtu sot jemi për raportimin e veprimtarisë së KQZ-së për vitin 2014, i cili sikurse u citua është në fakt një vit jo zgjedhor, por pavarësisht se ka qenë një vit jo zgjedhor, ka qenë një vit i ngarkuar me veprimtarinë e institucionit ku veprimtaria e të cilit është fokusuar kryesisht në realizmin e kërkesave të paraqitura nga Kuvendi i Shqipërisë në projektrezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së këtij komisioni.

Do ta filloja me buxhetin. Fondet e dhëna në dispozicion nga buxheti i shtetit u përdorën me efikasitet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ju raportin, sikurse e tha zoti kryetar, e keni tashmë të ezauruar, prandaj do të kaloja te plotësimi i vakancave në Kuvend, që erdhën si pasojë e dorëheqjes së mandateve nga anëtarët e qeverisë.

Është për tu përmendur fakti se Kodi Zgjedhor kur është konstatuar shkelja e kriterit të gjinisë. Pra, e shikon si sanksion plotësues zëvendësimin e çdo vakance në listën e subjektit me kandidatë vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar, por në të gjitha rastet nuk u arrit qëllimi për të cilin kodi e ka parashikuar këtë normë, për arsye edhe të shterimit të kandidateve femra në listat shumëemërore.

Kalojmë në veprimtarinë e KQZ-së, i cili këtë vit, në 2014-n, ka qenë risi e këtij komisioni për faktin se KQZ-ja ka analizuar vetë me shumë objektivitet çdo moment të punës së tij analizë, e cila qartësoi në fakt nevojën edhe për ndryshime dhe përmirësime të anës legislative kryesisht të Kodit Zgjedhor dhe atë të anës organizative, sigurisht me mbështetjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë prezencës së OSBE-së në Shqipëri, zyrës së Këhillit të Europës dhe UN Women .

KQZ-ja organizoi pesë tryeza teknike, në të cilat u trajtuan aspektet më të rëndësishme të procesit zgjedhor si: ushtrimi i së drejtës për të votuar peronat me aftësi të kufizuar shanset e barabarta dhe respektimi i kuotës gjinore në zgjedhje, fushata zgjedhore dhe media; praktikat më të mira të platformës së trajnimit të komisionerëve zgjedhorë dhe financimi i partive politike dhe e fushatave.

Diskutimi i hapur dhe gjithëpërfshirës nga përfaqësuesit e partive politike të organizatave të shoqërisë civile të institucioneve shtetërore qendrat e pavarura të përfaqësuesve të medieve dhe të ekspertëve të trupës së KQZ-së administratës së saj, ofruan për çdo aspekt të temave të trajtuara gjetje dhe përfundime të cilat do të shërbejnë për zgjidhje të suksesshme të sfidave që një proces zgjedhor bart dhe që për nga vetë natyra nuk mund të konsiderohen të tilla vetëm për të, por edhe për të gjithë aktorët dhe faktorët, të cilët kanë rol të drejtpërdrejtë në proces.

Përveç këtyre, KQZ-ja ka si kompetencë të vetën edhe kryerjen e trajnimeve për administrimin zgjedhor jashtë periudhës zgjedhore dhe në mënyrë periodike për të gjithë të interesuarit duke përcaktuar se këto trajnime mund të jenë të përgjithshme të specializuara për funksione të veçanta të administrimit të zgjedhjeve.

KQZ-ja synoi realizimin e një procesi efektiv gjithëpërfshirës si nëpërmjet tematikave të trajtimit ashtu edhe të shtrirjes gjeografike. Realizimi i trajnimeve jashtë periudhës zgjedhore u mundësua falë bashkëpunimit edhe të qeverisjes vendore për sigurimin e ambienteve dhe kushteve optimale në vlerësim të rëndësisë së temave të trajtuara dhe ata bënë gjithashtu pjesë të këtyre trajnimeve edhe vetë administratës së tyre.

Organizmi i programeve për edukimin zgjedhor të shtetasve është tjetër pikë e rëndësishme e punës së aktivitetit të KQZ-së dhe në zbatim të kësaj kompetence KQZ-ja merr masa dhe organizon programe për edukimin zgjedhor të shtetasve. Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve të zhvilluar nga KQZ-ja në vijimësi gjatë vitit 2014 në takime të drejtpërdrejta me zgjedhësit jo vetëm i kanë shërbyer përmbushjes së detyrimit ligjor, por kanë krijuar mundësitë për të evidentuar drejtpërdrejtë nevojat e zgjedhësve për informacion lidhur për procesin zgjedhor në tërësi, si dhe aspektet e tij në veçanti.

Në këtë kontekst KQZ-ja ka ndërtuar dhe miratuar edhe strategjinë për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet e datës 21 qershor. Pra e gjithë kjo periudhë i shërbeu për të ndërtuar këtë strategji.

Gjithashtu, KQZ-ja në vitin 2014 ka kaluar edhe kërkesa për referendum vendor nga grupet nismëtare, për të cilët, tani e dimë që Kolegji zgjedhor, vendosi shfuqizimin e vendimeve përkatëse të marra në datë 14 nëntor 2014 nga KQZ-ja dhe vendosjen në fund të rrëzimit të kërkesës së grupeve nismëtare. Kështu që këtu mbaron puna e KQZ-së në lidhje me këto referendume.

Veprimtaria e KQZ-së sigurisht zgjedhjet e ardhshme të 2015-ës i ka pasur në fokus gjatë gjithë veprimtarisë edhe në vitin 2014. Kjo kryesisht ka të bëjë me përditësimin e moduleve dhe programeve kompjuterike të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë. Me projektin e realizuar në bashkëpunim me IF-s për zgjedhjet e Kuvendit në 2013-ën, në fakt, u realizuan shumë module, por pas zgjedhjeve të 2013-ës KQZ-ja filloi punën për të koordinuar me donatorë të ndryshëm dhe për të mundësuar ndërrimin e plotë për administrimin e integruar të informacionit zgjedhor.

Kështu, gjatë vitit 2014 mundëm të sigurojmë financimet vetëm për përshtatjen, për zgjedhjet vendore të moduleve të zhvilluara të zgjedhjeve të mëparshme parlamentare. Financimi u dha përsëri nga USAID dhe u asistua nga nënkontraktora *System Impact*.

Ekspertët e huaj të kontraktuar nga donari në bashkëpunim me specialistët e KQZ-së arritën që të zhvillonin module përkatëse dhe në fillim të muajit tetor 2014 pas testeve dhe rregullimeve përkatëse u bë prezantimi në KQZ. Në modulet e përgatitura do të duhen të bëhen disa rregullime në bazë të ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor dhe patjetër do të jenë gati në zgjedhjet e qershorit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2014 KQZ-ja bashkëpunoi edhe me donatorë të ndryshëm për të siguruar financime për ndërtimin e plotë të sistemit për administrimin e integruar të informacionit zgjedhor.

Për të përfunduar ngritjen dhe për të mundësuar ndërtimin e plotë të këtij sistemi kemi propozuar zhvillimin e disa moduleve të tjera, të cilat kanë të bëjnë me modulën për menaxhimin e procesit për regjistrimin e subjekteve zgjedhore, verifikimin dhe vlefshmërinë e të drejtës së kandidatëve për të kandiduar, modulën për menaxhimin e ndarjes administrative të zonave të administrimit zgjedhor, vendeve të numrit të votave dhe qendrave të votimit, modulet për menaxhimin e të dhënave për qendrat e votimit, sikurse edhe modulet për menaxhimin buxhetor financiar për komisionet e nivelit të dytë dhe modulën për shpërndarjen e mandateve dhe historinë e tyre.

Me daljen e dekretit të Presidentit të Republikës dhe caktimit të datës së zgjedhjeve KQZ-ja miratoi edhe planin orientues të veprimeve. Miratimi i këtij plani orientues veprimesh përbën një dokument bazë për nisjen e veprimtarisë së KQZ-së në përputhje me përcaktimin e nenit 21 në këtë mënyrë duke ndërtuar një kalendar të veprimeve të veta, komisioni synon të përgatisë dhe të vendosë në një kornizë ligjore të gjithë sistemin në lidhje me zgjedhjet e ardhshme.

Përpos këtyre KQZ-ja ka pasur edhe aktivitete me partnerë ndërkombëtarë, bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Ajo që është për t'u vënë në fokus dhe theksuar është fakti që KQZ-ja është pjesë e *Election Working Group*. Është një mbledhje e cila i shërben qëllimit dhe koordinimit të pjesëmarrësve dhe identifikimit të nevojave të KQZ-së dhe të shoqërisë civile për dhënien e asistencës në fushat e zgjedhjeve.

Pas zgjedhjeve të 2013, ky organizëm nuk ka pushuar së funksionuari, por në mënyrë periodike jemi mbledhur. Kryesohet nga OSBE-ja dhe me të gjithë partnerët e tjerë.

Ne kemi qenë prezentë në çdo mbledhje dhe kemi diskutuar në lidhje me veprimtarinë e KQZ-së por sigurisht me çfarë ne kërkojmë të arrijmë në të ardhmen.

Dua të përmend edhe anëtarësimin e KQZ-së në aktivitetet ndërkombëtare. Ne jemi anëtar të ACEO-s, jemi anëtar të AOEB-it, organizata, të cilat kanë të përbashkët faktin që jemi të gjithë trupa zgjedhorë ku ne përfaqësohemi denjësisht. Në çdo takim dhe konferencë që kemi qenë KQZ-ja të Shqipërisë është paraqitur me prezantimet e KQZ-së dhe të asaj çfarë ne kemi arritur duke bërë krahasimet me të gjitha proceseve zgjedhore me njëri-tjetrin.

Në fund, dua të ndalem për auditin e financimeve të partive politike. Është një pikë sensitive për të gjithë. Ne e kemi prekur atë në vitin 2014 dhe ka qenë një nga tryezat që ka qenë shumë e diskutueshme për faktin se e thashë edhe më parë është sensitive. KQZ-ja është konshiente se procesi i verifikimeve dhe kontrollit të financimit të partive politike është një proces që nuk ka dhënë në fakt rezultat e kërkuara për dy arsye:

E para, mungesa e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare për të kryer në mënyrë të plotë këtë kompetencë.

E dyta, numri i madh i partive politike, të cilat, edhe pse janë të regjistruara në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, rezultojnë inekzistente, pasi as adresat dhe as kryetarët e tyre nuk gjenden.

Së fundi, duke respektuar pavarësinë dhe paanshmërinë e institucionit që drejtojmë do të respektojmë dhe do të jemi shumë të vëmendshëm ndaj çdo mesazhi tuaj. Prandaj shpreh besimin

për zbatimin dhe sugjerimeve e komandimeve të cilat do të paraqiten për këtë raport nga Kuvendi i Shqipërisë dhe ju siguroj se si trup zgjedhor KQZ-ja do të mbetet tërësisht i angazhuar për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor të radhës për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta të ndershme në përputhje me standardet e kërkuara.

Në mënyrë të përmbledhur ky ishte raporti.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Luzi!

Zoti Klosi, urdhëroni si relator!

Blendi Klosi – Shumë shkurt do të flas, sepse këtu mungon edhe opozita, e cila duhej të ishte pjesë e këtij debati duke vlerësuar edhe rëndësinë që ka ky institucion në muajt që do të vijnë.

Viti që kaloi ka qenë një vit, ashtu siç shprehet edhe në raportin e këtij institucioni, më shumë i fokusuar te trajnimet, përgatitjet, administrimin e problemeve të brendshme, por siç e thatë edhe ju, ky vit që vjen do të jetë një vit shumë i rëndësishëm për këtë institucion. Natyrisht nuk do të donim të ndodheshim në debate që kemi bërë gjithmonë në KQZ. Prandaj në këtë aspekt unë vlerësoj analizën që ka bërë shërbimi i monitorimi të institucioneve të pavarura në raportin e tyre të plotë, po ashtu edhe projektrezolutën e paraqitur për diskutim në komisionin tonë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Klosi!

Ka pyetje? Nuk ka

(Diskutime pa mikrofon.)

Diskutime për rezolutën? Nuk ka.

Kush është dakord me projektin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Komisionin e kanë mirë, por administrata ka nevojë... Një nga çështjet që unë mendoj që duhet të zërë në vend në projektrezolutë është çështja e administratës. Administrata nuk ka performuar në zgjedhjet e mëparshme dhe unë nuk pashë, edhe në këtë raport, që ne kemi trajnuar gjithë Shqipërinë, por nuk kemi trajnuar dhe nuk kemi parë eficiencën e asaj administrate. Kështu që kjo është një çështje që shërbimi i monitorimit duhet ta trajtojë në projektrezolutë.

E mbyllim me këtë sugjerim.

Faleminderit!

Gjithë të mirat!

Një vit zgjedhor të mbarë, zonja kryetare, zoti nënkryetar!

Faleminderit, kolegë!

Nesër është seanca plenare.

MBLEDHJA MBYLLET